


BULETINI TREMUJOR
FONDI I KURSIMEVE PENSIONALE TË KOSOVËS



TRUSTORJA

PERFORMANCA KUMULATIVE E FKPK-SË PREJ THEMELIMIT



| PERIUDHA | 1M | 3M | 1 VIT | 3V | 5V | NGA THEMELIMI |
|------------|--------|-------|--------|--------|--------|---------------|
| REZULTATI | -1.27% | 3.47% | 2.27% | 17.91% | 27.53% | 31.71% |
| BENÇMARKU* | -0.08% | 0.60% | -0.16% | -0.08% | 7.27% | 31.10% |

*INDEKSI I HARMONIZUAR I ÇMIMEVE TË KONSUMIT I PUBLIKUAR NGA AGJENCIA E STATISTIKAVE TË KOSOVËS

PERFORMANCA DHE KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM4 2015

ÇMIMI I AKSIONIT:

| | |
|----------------------------------|-----------------|
| TETOR | ▲ +4.27% |
| NËNTOR | ▲ +0.52% |
| DHJETOR | ▼ -1.27% |
| GJITHSEJ PERFORMANCA NETO | ▲ +3.47% |


KTHIMI BRUTO:

| | |
|------------------------------|--------------------|
| TETOR | +€50.05 mln |
| NËNTOR | +€6.83 mln |
| DHJETOR | -€15.17 mln |
| GJITHSEJ KTHIMI BRUTO | +€47.72 mln |

FAKTET KRYESORE

| | |
|--|--|
| ÇMIMI I AKSIONIT €1.3171 | MJETET NETO NËN MENAXHIM €1,229,333,327.33 |
| PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË TREMUJOR €4.36 mln | PENSIONE TË SHPAGUARA KËTË VIT €19.23 mln |
| LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË TREMUJOR 947 | LLOGARI TË PENSIONUARA KËTË VIT 4,803 |
| LLOGARI TË KONTRIBUESVE 507,963 | LLOGARI AKTIVE KËTË VIT 297,466 |
| KONTRIBUES TË RINJ KËTË TREMUJOR 8,884 | KONTRIBUTE KËTË TREMUJOR €34.86 mln |
| SHËRBIME TË OFRUARA KËTË TREMUJOR 16,361 | GJITHSEJ LLOGARI TË AKTIVIZUARA NË eTRUSTI 48,427 |

ALOKIMI I MJETEVE NË FUND TË TREMUJORIT



€29.6 MLN KTHIMI BRUTO PËR 2015

Tremujori i katërt (TM4) i 2015-s bëri që i gjithë viti të kalojë në kuota pozitive. Kthimi bruto për këtë periudhë ishte €41.7 milionë, duke bërë që viti të shkojë në +€29.6 milionë. Ndërsa çmimi i njësisë në €1.3171 ose një ngritje prej +2.27% për vitin. Performanca pozitive e investimeve ndikoi edhe në rritjen e mjeteve nën menaxhim, që gjatë tremujorit u shtuan për €73.7, dhe për gjithë vitin për €142 milionë, për të arritur në €1.23 miliardë. Kurse kontributet e reja për TM4 ishin €36.2 milionë, ndërsa për vitin €137.5 milionë. Andaj në terma të TM4 kthimi nga investimet kontribuoj më shumë në rritjen e mjeteve nën menaxhim, por në vlerësimin vjetor kontributin kryesor e dhanë kontributet e reja. Sa i përket mjeteve të dala nga FKPK-ja, në bazë vjetore: €19.2 milionë shkuan për pagesë të pensioneve, €5.8 milionë për tarifa (investuese dhe operacionale) dhe €380 mijë ishin refondime drejt ATK-së.

FAKTORËT ME NDIKIM

Në TM4 në fokus kryesor ishin zhvillimet në SHBA, në pritje të vendimit të FED-it për përfundimin e programit të lehtësirave monetare, duke i rritur normat e interesit për herë të parë prej 2006-s. Kjo ndodhi pas publikimit të treguesve makroekonomikë që shfaqnin përmirësim të fortë, dhe me papunësinë që ra nën 5%, niveli më i ulët në 7 vjet. Ky veprim rriti besimin dhe shtoi oreksin e investitorëve duke ndikuar në ngritjen e tregjeve. Në anën tjetër, rënia e shpejtë dhe e fortë e çmimit të naftës, ndikoi negativisht në ditët fundit të vitit, me çka u gërrye një pjesë e mirë e rritjes në këtë tremujor por edhe për vitin.

PERFORMANCA E FONDEVE INVESTUESE

Përmirësimi i tregjeve financiare u ndoq edhe nga fondet e investuese të FKPK-së, që përveç AXA GILB, të gjithë e mbyllën tremujorin me rezultate pozitive. Më së miri doli portoli i KBI, me shpërndarje më të madhe në sektorin financiar (21%), dhe për shkak të përqendrimit të fortë në SHBA e Japoni (61% e 9%). Indeksi kryesor i kësaj të fundit (Japonisë) e kishte performancën më të mirë në TM4 në të gjitha tregjet e aksioneve, me +9.8% në terma të monedhës japoneze. Më pas ishte fondi i Nordea GSEF (+8.95%), me shpërndarjen më të madhe në produktet shëndetësore (26%), dhe me përqendrim të fortë në SHBA e Japoni (65% e 8%). I treti ishte fondi i Pictet (+8.79%), që në fakt ka shpërndarje më homogjene në sektorë dhe shtete: në produktet mjekësore (17%) dhe në SHBA (42%). Dy fonde të tjera që performuan mjaft mirë ishin të tregut të aksioneve: Vanguard (+6.19) dhe Tobam (+5.69%). Ky i fundit e pati edhe performancën më të dobët vjetore (-4.70%). Fondet me më shumë bono në portofol performuan më ulët, të ndikuar nga normat e interesit në këtë instrument: AXA-WFOI (+3.50%), Nordea SRF (+2.26%), BNY Mellon (+1.29%). Edhe më keq ishte për fondin e pastër në bono të Schroders (+0.34%), që ngeli për pak në kuota pozitive për tremujorin, por në territoret mjaft negativ për vitin (-2.57%). Ndërsa i vetmi fond me rezultat negativ për TM4, i AXA GILB (-2.11%), njëherësh negativ edhe për vitin (-0.74), vazhdon të vuajë nga rënia e çmimeve të prodhimeve dhe zhvlerësimi i monedhave, që kanë emëruar të përbashkët: rënien e fortë të çmimit të naftës.

Investimet në Kosovë ishin me norma të paracaktuara të interesit dhe nuk ndikohen nga faktorë të jashtëm. Interesi i mbledhur për periudhën për investimet në depozita ishte mesatarisht 0.28%, dhe për bono 0.57%.

KTHIMI NGA INVESTIMET NË TM4

+3.47%

KTHIMI NGA INVESTIMET PËR VITIN

+2.27%

PLASMANET DHE PERFORMANCA PËR SECILIN MENAXHUES/EMETUES

| MENAXHUESI/EMETUESI | EMRI I FONDIT/INSTRUMENTIT/BANKËS | PLASMANET | PERFORMANCA |
|---------------------------------|--|--------------------------|---------------|
| Vanguard | Global Stock Index Fund - Euro | €348,579,354.87 | +6.19% |
| BNY Mellon | Global Real Return Fund | €170,643,378.77 | +1.29% |
| Schroders | Strategic Bond - Euro Hedged | €111,573,427.92 | +0.34% |
| Nordea | 1-Stable Return Fund | €145,649,844.60 | +2.26% |
| AXA | Global Inflation Linked Bonds | €95,816,362.75 | -1.40% |
| Thesari i Republikës së Kosovës | Obligacione dhe fletobligacione | €89,637,100.82 | +0.57% |
| KBI | Divident Plus | €58,909,446.40 | +10.08% |
| Nordea | 1-Global Stable Equity Fund | €57,695,077.17 | +8.95% |
| TOBAM | Anti-benchmark WEFÉ hedged share class | €35,032,098.14 | +5.69% |
| Pictet | High dividend selection Z EUR | €32,956,868.29 | +8.79% |
| AXA | WF Optimal Income I EUR | €27,877,091.00 | +3.50% |
| BANKA KOMBËTARE TREGTARE | Depozitë me afat | €3,009,082.19 | +0.30%* |
| BANKA PËR BIZNES SH.A. | Depozitë me afat | €3,008,013.70 | +0.27%* |
| GJITHSEJ | | €1,134,533,594.70 | +3.47% |

*Performanca në këto raste është për çështje ilustrimi dhe nuk lidhet me investimin, pasi janë depozita me afat, me interes të paracaktuar. Norma e paraqitur është për interesin e mbledhur për periudhën fundtetori deri më 31 dhjetor.

KUVENDI EMËROI PESË ANËTARË TË BORDIT

Në mbledhjen e mbajtur më 30 nëntor 2015, Kuvendi i Republikës së Kosovës i ka emëruar pesë anëtarë të Bordit Drejtues të FKPK-së me mandat tre-vjeçar. Kuvendi në këtë mbledhje vendosi që Kryesues i Bordit të jetë z. Ymer Havolli, dhe anëtarë profesionistë të jenë z. Behxhet Haliti, z. Frederick Artesani, z. Joly Dixon, kurse anëtar përfaqësues i punëmarrësve u emërua z. Ruzhdi Morina.

Me këtë edhe është tejkaluar boshllëku i krijuar prej fundit të tetorit, kur pesë anëtarëve u kishte skaduar përfundimisht mandati, dhe Bordi Drejtues nuk e kishte kuorumin për marrjen e çfarëdo vendimi. Pas funksionalizimit të Bordit, janë plotësuar dhe aktivizuar edhe komisionet e Bordit, të cilat trajtojnë fillimisht çështjet para diskutimit dhe votimit të tyre në mbledhjet e Bordit. Komisioni i Investimeve do të udhëhiqet nga z. Frederick Artesani, Komisioni për Buxhet nga z. Ymer Havolli, Komisioni për Ankesa nga z. Ruzhdi Morina dhe Komisioni për Auditim nga z. Flamur Keqa.

Ndërkohë, sa i përket konkursit të rishpallur në tetor për një anëtar profesional, FKPK-ja nuk është në dijeni të zhvillimit të procesit.

22% MË SHUMË SHËRBIME MË 2015

Numri i shërbimeve të ofruara nga zyra e FKPK-së për vitin 2015 arriti në 72,266 (2014: 59,030), ose një rritje me 22%, ndërsa numri i shërbimeve të ofruara nga zyrat rajonale të ATK-së u shtua për 45% në 43,608 sosh. Ndërkohë numri i vetëshërbimeve ra për 25%, kryesisht për shkak se më pak kontribuues kanë nevojë t'i korrigjojnë të dhënat e tyre të kontaktit.

Pesë shërbimet më të kërkuara më 2015 në zyrën e FKPK-së ishin: shtypja e pasqyrave (47%), hapja e llogarive në eTrusti (15%), shtypja e njoftimeve për pensionim (9%), ndryshimi i adresave të banimit (6%) dhe aplikimi për pension (5%).

Në total këtë vit, në zyrën e FKPK-së dhe zyrat rajonale të ATK-së, janë dhënë 115,874 shërbime, ose 30% më shumë se më 2014, kur u dhanë 89,088 shërbime.

BORDI NDRYSHON PJESË TË STRATEGJISË DHE ALOKIMIN E MJETEVE

Në mbledhjen e parë të Bordit Drejtues në përbërje të re, një nga pikat kryesore ka qenë rishikimi i strategjisë aktuale të investimeve, por edhe rishikimi i performancës së investimeve aktuale. Ndryshimet në strategji do të prekin kryesisht investimet në bonot drejtimore, për t'i dhënë më shumë hapësirë investimeve në multi-asete, që japin shkallë të kënaqshme të riskut dhe ofrojnë potencial më të madh të kthimit nga investimi sesa bonot.

Në këtë drejtim, hap konkret është tërheqja e investimit të plotë nga fondi i Tobam (€33 mln), për shkak të performancës jo të kënaqshme, dhe ulja rrënjësore e investimit në Schroders, nga i cili do të tërhiqen €100 mln, për shkak të parashikimeve të ulëta për rritje në tregun e bonove. Këto mjete më pas do të drejtohen në: AXA WFOI (€30 mln), BNY Mellon (€30 mln), Nordea SRF (€30 mln), Nordea GSEF (€19 mln), Pictet (€7 mln), KBI (€7 mln), dhe në bono të Kosovës (€10 mln).

Më pas, Bordi ka parashikuar edhe angazhimin e fondeve të reja të investimeve në instrumente të aksioneve dhe multi-aseteve, për çka edhe do të shpallen thirrje për oferta në nivel ndërkombëtar.

394 MIJË PASQYRA VJETORE PËR KONTRIBUESIT

Stafi i FKPK-së i ka gjeneruar tashmë pasqyrat të cilat do të shtypen dhe dërgohen në Postën e Kosovës për shpërndarje tek kontribuuesit. Janë 394 mijë pasqyra vjetore që FKPK-ja do t'i nisë tek kontribuuesit në gjithë vendin. Një vit më parë ky numër ishte 432 mijë, e me qëllim uljen e shpenzimeve, FKPK-ja këtë vit nuk ua dërgon pasqyrën kontribuuesve që kanë llogari në eTrusti, pasi ata kanë qasje ditore në llogarinë e tyre, dhe i kanë të gjitha informacionet për kursimet e tyre pensionale. Sidoqoftë, kontribuuesve nuk u është vënë asnjë kufizim që në çfarëdo kohe të kërkojnë pasqyrën e tyre të llogarisë drejtpërdrejt në zyrën e FKPK-së në Prishtinë dhe zyrat rajonale të ATK-së.

INVESTIME REKORDE NË KOSOVË: €96 MLN

Investimet e FKPK-së në Kosovë arritën shifër rekord prej €95.7 mln në fund të këtij viti. Pjesa më e madhe e këtyre investimeve ishte në bono të emetuara nga Qeveria e Kosovës, prej rreth €90 mln, kurse €6 mln ishin në depozitat e dy bankave komerciale (BKT Kosova dhe BPB). Një vit më parë investimet në Kosovë ishin rreth €54.7 mln ose 75% më pak. Në këtë mënyrë dëshmohet gatishmëria e FKPK-së që gjithnjë e më shumë mjete të investohen në vend, për sa kohë kjo është e mundshme me ligj dhe investimi është në interes të kontribuuesve.

€4.4 MLN PENSIONE TË SHPAGUARA NË TM4

Pensionet e shpaguara gjatë TM4 (prej €4.4 mln) ishin më të larta se gjatë TM3 (prej €3.2 mln). Më tej, vlera e përgjithshme e mjeteve të shpaguara për vitin 2015 arriti në rreth €19.2 mln, ndërsa një vit më parë kjo shumë ishte €14.3 mln, ose për 34.3% më pak.

Në terma të krahasimit vjetor, numri i përfituesve të pensionit është rritur për 13.9% (nga 4,049 në 4,610). Më 2015 nga të gjithë të pensionuarit pension i moshës ishin 3,360 (ose 79%), raste të vdekjes ishin 789 (ose 17%) dhe të invaliditetit 191 (ose 4%).

Sa i përket bilancit mesatar të llogarive në fund vitit 2015: për llogaritë aktive është rritur për 9% në €3,103 (31.12.2015: €2,855) ndërsa për të gjitha llogaritë ekzistuese është rritur për 7% në €2,143 (30.12.2014: €2,006).

Mosha mesatare e kontribuuesve aktivë në fund të vitit ishte 38 vjeç (fundviti 2014: 38 vjeç), ndërsa për të gjitha llogaritë 39 vjeç (fundviti 2014: 38 vjeç).

48,427 LLOGARI NË eTRUSTI

Numri i kontribuuesve që kanë aktivizuar llogari në shërbimin e bazuar në internet, eTrusti, shkoi në 48,427 në fund të 2015-s, një numër ky për 30% më shumë se një vit më parë, kur ishin 37,222 llogari.

Ndikimin kryesor në këtë rritje e pati zhvillimi i fushatave promovuese në televizione, por edhe promovimi i tij tek klientët gjatë ofrimit të shërbimit në zyrë.

Ky numër aktualisht përbën sa 9.5% e totalit të kontribuuesve që kishin llogari të kursimeve pensionale në fund të vitit (507,771), dhe duke pasur parasysh se rreth 85% e kosovarëve përdorin internet, ekziston potencial i madh i shtimit të numrit të përdoruesve të këtij shërbimi.

BOTUES:

Fondi i Kursimeve Pensionale të Kosovës
Janar 2015

REDAKTOR:

Vërshim Hatipi

AUTOR:

Jeton Demi

KONTAKT:

Rr. "Agim Ramadani" Nr. 10,
10000 Prishtinë

038-244-341

info@trusti.org

www.trusti.org